



REPUBLIKA E SHqipërisë



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

VENDIM

Nr.15, Datë: 30.12.2020

"Mbi miratimin e Shpërblimit mujor të anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2021"

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e Datës 30.12.2020, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi shqyrtoi materialin e përgatitur nga zyrtarët e administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër "Mbi miratimin e Shpërblimit mujor të anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2021", bazuar në: Ligjit Nr.139/2015, Datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nenit 72 pika 5, neni 77,78, Ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve" germën c) të nenit 5, VKM-në Nr.165 Datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kushteve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, Ligjin nr. 137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021" i ndryshuar; Bazuar në Aktin Normativ Nr.03 datë: 15.03.2020 konkretisht neni 5. "për vendimarrjen e organeve kolegjiale gjatë gjendjes së infeksionit Covid-19", si dhe bazuar në Urdhërin Nr.80 datë 17.11.2020 "për miratimin e rregullave dhe procedurave standarde të punës të harmonizuara, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19...bazuar në Urdhërin nr.633 datë 17.11.2020 "për ndalimin e grumbullimeve me më shumë se 10 persona në vende të mbyllura apo të hapura...", Duke marrë shkas nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19, mbledhja e Këshillit të Qarkut Shkodër u zhvillua online nëpërmjet platformës Zoom, pas relativitetit nga zyra e drejtorisë së financës dhe buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **13 Vota Pro, 1 Votë Kundër dhe 0 Vota Abstenim.**

Në përfundim Këshilli i Qarkut Shkodër

VENDOSI:

1. Të miratojë shpërblimin mujor të Anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër për Vitin 2021, i cili do të jetë në masën 10% të pagës së Kryetares së Këshillit të Qarkut Shkodër.
2. Burimi financiar do jenë transferata e pakushtëzuar, sipas detajimit të Buxhetit të Vitit 2021.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.



Scanned with the
Scanner App



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

RELACION

"Mbi miratimin e Shpërblimit mujor të anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2021"

Institucioni i Këshillit të Qarkut Shkodër paraqet për shqyrtim, diskutim dhe miratim Përqindjen e Shpërblimit mujor të anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2021.

Duke u bazuar në përmbajtjen e Ligjin Nr.139/2015, Datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", përkatësisht në pikën 5 të nenit 72, ku thuhet se "anëtarët e këshillit të qarkut kryejnë funksione pa shpërblim, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur anëtarë të kryesisë së këshillit të qarkut", neni 78, germën "c" të nenit 5 të Ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve VKM-në si dhe ne VKM Nr.165 Datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të njësive të vetëqeverisjes vendore", sipas të cilit "shpërblimi mujor deri në masën 10% të pagës mujore të kryetarit të këshillit të qarkut" i ndryshuar, paraqesim për miratim për qindjen e Shpërblimit mujor të anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2021.

Për vitin 2021, Institucioni i Këshillit të Qarkut Shkodër propozon për të miratuar masën e shpërblimit mujor të anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodëri cili të jetë 10% të pagës së Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër .

Nëpunësi Zbatues

Gjyljana MIRUKU



Scanned with the
Scanner App